

**STATUTI**  
**DHE**  
**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISË TREGTARE**  
**“better.” sh.p.k.**

Në këtë Statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, (i përditësuar).
- “Ligji për QKB” është Ligji Nr. 131/2015, datë 26.11.2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.
- “Ligji për Regjistrimin e Biznesit” është Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, (i përditësuar).
- “Statut” është Statuti i Shoqërisë Tregtare “Better” sh.p.k.

**KREU I**  
**EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Emërtimi, Forma dhe Ortakët**

1.1. Sot, më datë 27.02.2020, në mbështetje të legjislacionit shqiptar në fuqi, ne Ortakët e Shoqërisë, kemi miratuar këtë Statut të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**better.**” sh.p.k., me emërtimin tregtar “**better.**”, e cila organizohet dhe funksionon si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shndërrimi i saj në një formë tjetër do të realizohet në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i përditësuar).

1.2. Shoqëria zotërohet nga Ortakët:

- **Z. Fatjon Hallkaj**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, lindur me 09.02.1994, ne Athine, mbajtes i leternjoftimit nr. 031588602 dhe nr. personal J40209053I.
- **Z. Arsen Shkenza**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, lindur me 01.04.1995, ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. 033356267 dhe nr. personal J50401070L.
- **Z. Orland Karamani**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, lindur me 08.04.1993, ne Lac, mbajtes i pasaportes nr. BR3484971 dhe nr. personal J30408095G.
- **Z. Besian Arizi**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, lindur me 21.01.1984, ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. 030973379 dhe nr. personal I40121053S.

**Objekti**

- 2.1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "better." sh.p.k. do të zhvillojë aktivitetet si më poshtë:
- a. Dizajn software-i.
  - b. Analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software;
  - c. Zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemeve software.
  - d. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponenteve, suporti i sistemit si një tërësi komponentesh, që në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;
  - e. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve që lidhen me aktivitetet e "better." Shpk.
  - f. Aktiviteti i shërbimeve mbi software aplikative të zhvilluara nga vete Shoqëria "better." sh.p.k, ose software të tjera ku ka kompetencë.
  - g. Aktiviteti i implementimit të sistemeve Database, Middleware, BI, Data Warehouse dhe platformave që shërbejnë për zhvillime të aplikacionesh, objekt i veprimtarisë së "better." Shpk.
  - h. Dizajn, programim, zhvillim, konsulence, shërbime dhe veprimtari në fushën e sistemeve software GIS dhe WebGIS, strukturim dhe krijim i bazave të të dhënave hapësinore, zhvillime analizash.
  - i. Aktivitetet në shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së softwareve.
  - j. Aktivitetet në shërbime të përpunimit të të dhënave.
  - k. Software si shërbim.
  - l. Aktivitetet në shërbime të hostimit të bazave të të dhënave dhe të dhënave përkatëse.
  - m. Testim software.
  - n. Testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software;
  - o. Dizajn dhe zhvillim të sistemeve të komunikimit.
  - p. Analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);
  - q. Aktiviteti i shitjes së produkteve dhe shërbimeve që ka në objektin e veprimtarisë.
  - r. Aktiviteti i shitjes së pajisjeve ICT.
  - s. Aktiviteti i shitjes së licencave software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to.
  - t. Trajnime dhe kurse të Formimit Profesional për çdo specialitet që lidhet me aktivitetet e "better." Shpk.
  - u. Aktiviteti i konsulencës në fushën e software aplikative.
  - v. Dizajn dhe zhvillim të sistemeve të sigurisë. Analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;
  - w. Zhvillim të sistemeve migrimi.
  - x. Transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re;
  - y. Përmirësim/upgrade të sistemeve informatike;
  - z. Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.

- aa. Krijimin e nje hapësire te hapur per komunitetin e apasionuar pas teknologjise me qellim zhvillimin e kerkimeve shkencore, ndarjen e ideve, përvojave, problematikave te hasura etj duke i vene ne dispozicion anetareve te vete mjedise dhe mjete teknologjike te shoqerise "better." pa detyrime financiare te ndersjellta.
- 2.2. Shoqeria mund te kryeje edhe veprimtari te tjera ndihmese te cilat mbeshtetin arritjen e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- 2.3. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "better." sh.p.k. zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

- 3.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë "better." sh.p.k. është e pakufizuar.

### **Neni 4 Selia**

- 4.1. Selia e Shoqërisë "better." sh.p.k. është në adresën Rr. Pjeter Bogdani, Tirane apartamenti Nr.5, Kati 1, Pallati 10 katesh i perbere 2+1, ambjente ndihmese me siperfaqe 60 m2 dhe siperfaqe veerande 22m2.
- 4.2. Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj. Për këtë arsye, ajo mund të hapë dhe degë/seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 5 Shuma dhe Pagesat e Kapitalit të Regjistruar**

- 5.1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë "better." sh.p.k. është 1000 (njëmijë) lekë i ndarë në 4 (kater) kuote. Vlera e kuotës së Ortakut është e barabartë me vlerën e kontributit të tij në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, e cila do të quhet "vlerë nominale",
- 5.2. Pjesëmarrja e Ortakëve në kapitalin e Shoqërisë "ITD" sh.p.k. është si më poshtë:
- Z.Fatjon Hallkaj. zotëron një kuotë të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, e cila përbën 20% të tij, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.
  - Z. Arsen Shkenza, zotëron një kuotë të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, e cila përbën 20% të tij, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.

- Z.Orland Karamani, zotëron një kuotë të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, e cila përbën 20% të tij, me vlerë nominale 200 (dyqind) lekë.
  - Z.Besian Arizi, zotëron një kuotë të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, e cila përbën 40% të tij, me vlerë nominale 400 (katerqind) lekë
- 5.3. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të perbehet nga kontribute në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) nga fitimi dhe nga çdo lloj tjetër kontributi i përcaktuar në ligj.

### **Neni 6 Transferimi i Kapitalit**

- 6.1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin prej tyre, mund të transferohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 6.2. Transferimi i kuotave të kapitalit në favor të personave të tretë, kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së Ortakëve.

### **Neni 7 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

- 7.1. Kapitali i Shoqërisë mund të rritet pa kufi, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen, në përputhje me raportin e vlerës nominale të kuotës së secilit Ortak në kapitalin e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur Asambleja aprovon rritjen e kapitalit me kontributet e njërit ose disa prej Ortakëve të Shoqërisë.
- 7.2. Gjithashtu, kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet, me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, por asnjëherë nën kufijtë e parashikuar nga Ligji.
- 7.3. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet me kontribute në para, në natyrë, nga fitimi dhe nga çdo lloj tjetër kontributi i përcaktuar në ligj.

### **Neni 8 Certifikata e Kuotave të Kapitalit**

- 8.1. Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës/ave të kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave që zotërojnë kuotën/at dhe nuk përbën letër me vlerë.

## **KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

### **Neni 9**

## Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 9.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organ vendimmarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga Ortakët e saj.
- 9.2. E drejta e votës për secilin Ortak është në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij, e barazvlefshme me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit Ortak në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, konkretisht:
  - Z. Fatjon Hallkaj zotëron 20% të kuotave.
  - Z. Arsen Shkenza, zotëron 20% të kuotave.
  - Z. Orland Karamani, zotëron 20% të kuotave.
  - Z. Besian Arizi, zotëron 40% të kuotave.
- 9.3. Në përputhje me Ligjin, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve merr vendime:
  - a. Me shumicë të zakonshme;
  - b. Me shumicë të kualifikuar.
- 9.4. Për vendimet që kërkojnë shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave. Për këto çështje, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 9.5. Për vendimet që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave. Për këto çështje, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës me të drejtë vote.
- 9.6. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të Ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

### Neni 10

#### Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 10.1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. Ndryshimet e Statutit;
  - c. Emërimin e shkarkimin e Administratorit të Përgjithshëm;
  - d. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e. Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorin, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
  - f. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- j. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - k. Shpërndarjen e fitimeve;
  - l. Nisjen e hetimeve të posaçme lidhur me parregullsitë përgjatë veprimeve të ushtrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
  - m. Ngritjen e padisë përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin në gjykatë të vendimeve të Administratorit të Përgjithshëm, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të Ligjit ose Statutit;
  - n. Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorit të Përgjithshëm;
  - o. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - p. Aprovimin e kompetencave shtesë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - q. Miratimin e Autorizimit të Posaçëm për shfuqizimin e ndalimit të përmendur në pikën 1 e 2 të Nenit 17 të Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 10.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ushtron çdo të drejtë tjetër të parashikuar nga Ligji si kompetencë të saj.

#### Neni 11

#### Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

- 11.1. Procedurat për thirrjen, zhvillimin dhe votimin në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve do të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i përditësuar).

#### Neni 12

#### Administratori i Përgjithshëm

- 12.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron një person fizik si Administrator të Përgjithshëm të Shoqërisë, sipas Nenit 81, paragrafi 1, pika c) dhe Nenit 95 të Ligjit.
- 12.2. Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i Përgjithshëm:
- **Z. Fatjon Hallkaj**, identifikuar me leternjoftim ID me nr.031588602 dhe nr.personal J402090531, me adrese: 1052 Yzberish, Rr. “Sabri Preveza, Ap.27, shk,46 Tirane, Shqipëri, për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga data e themelimit të saj.

#### Neni 13

#### Kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm

- 13.1. Administratori i Përgjithshëm detyrohet para Shoqërisë të respektojë kufizimet e përcaktuara me Ligj dhe nga Statuti, lidhur me hapësirën e autoritetit të tij menaxhues.
- 13.2. Kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm janë:

- a) Kryen veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke respektuar kufizimet e vendosura në Ligj dhe Statut, në zbatim të politikave tregtare dhe detyrave të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- b) Përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- d) Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për miratim;
- e) Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- f) Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për QKR;
- g) Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare, detyrave dhe realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë.

#### Neni 14

#### Përgjegjësitë e Administratorit të Përgjithshëm

- 14.1. Administratori i Përgjithshëm është përgjegjës individualisht ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
- 14.2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, në varësi të kompetencave dhe që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen Administratorit që ka bërë marrëveshjen, për t'i përballuar në mënyrë individuale ose solidare, sipas rastit.
- 14.3. Administratori i Përgjithshëm detyrohet:
  - të kryejë detyrat e tij, të përcaktuara në Ligj ose në Statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - të ushtrojë kompetencat që i njihen në Ligj ose në Statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 14.4. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë Administratorin e Përgjithshëm në çdo kohë, me shumicë të zakonshme.

#### Neni 15

#### Përfundimi i detyrës së Administratorit të Përgjithshëm

- 15.1. Detyrat e Administratorit të Përgjithshëm përfundojnë në rast se:
  - A. Përfundon kohëzgjatja për të cilën është emëruar.
  - B. Shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me shumicë të zakonshme, në çdo kohë.

C. Administratori jep dorëheqjen.

- c.1. Në këtë rast, Administratori njofton me shkrim Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë, për emërimin e Administratorit të ri, të paktën shtatë ditë para datës në të cilën hyn në fuqi dorëheqja e Administratorit.
- c.2. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e Administratorit të ri, në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga Administratori, atëherë Administratori njofton me shkrim dorëheqjen në QKB bashkë me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe QKB-ja regjistron largimin e Administratorit.

## **KREU IV DIVIDENDËT DHE SHPËRNDARJA PARAPRAKE E FITIMEVE**

### **Neni 16 Dividendët**

- 16.1. Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Në lidhje me fitimin e shoqërisë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë:
  - shpërndarjen e plotë ose të një pjese të tij;
  - kapitalizimin e të gjithë fitimit ose të një pjese të tij;
  - mbajtjen e të gjithë fitimit ose të një pjese të tij në formën e rezervës statutore.
- 16.2. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja në përputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme. Në bazë të Ligjit, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortakët vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:
  - aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit;
  - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme, brenda 12 muajve të ardhshëm.
- 16.3. Administratori i Përgjithshëm lëshon një Certifikatë të Aftësisë Pagueuse, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 16.2. Kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, Administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.
- 16.4. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, pa u mbyllur viti financiar, mund të vendosë shpërndarjen paraprake të fitimit, i cili rezulton nga bilanci i një periudhe të ndërmjetme, me kusht që të plotësohen kërkesat e pikës 16.2 të këtij neni dhe në përputhje me Certifikatën e Aftësisë Pagueuse, të lëshuar nga Administratori i Përgjithshëm, sipas pikës 16.3 të këtij neni.



**KREU V**  
**MODIFIKIMI I FORMËS LIGJORE; PRISHJA E SHOQËRISË**

**Neni 17**  
**Modifikimi i Formës Ligjore**

- 17.1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin Shqiptar.
- 17.2. Shoqëria e re do të respektojë të gjitha kërkesat dhe procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

**Neni 18**  
**Prishja e Shoqërisë**

- 18.1. Shoqëria mund të priset në rrethanat e mëposhtme:
- me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
  - në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë;
  - në raste të tjera, të parashikuara në Statut;
  - në raste të tjera, të parashikuara me Ligj.
- 18.2. Administratori i Përgjithshëm regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të “Ligjit për Regjistrimin e Biznesit”.
- 18.3. Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata në përputhje me nenin 45 të “Ligjit për Regjistrimin e Biznesit”, ia dërgon vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

**KREU VI**  
**TË NDRYSHME**

**Neni 19**  
**Largimi i Ortakut**

- 19.1. Largimi dhe përjashtimi i një Ortaku, si dhe pasojat që kjo sjell, do të rregullohen nga Ligji “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare”.

**Neni 20**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

20.1. Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Statutit, të zgjidhet nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


**Neni 21**  
**Të tjera**


21.1. Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Ky Statut mbyllet me njëzet e një nene dhe nënshkruhet nga Ortakët në 5 (pese) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore.

**Nënshkrimi i Ortakëve**

Featjon Halilaj 

Orlando Karameani 

Arman Shkërruz 

Besian Arizi 